

# POLICY BRIEF

## **Funksionimi i Mekanizmit Kombëtar të Referimit të Dhunës në Familje**

*Rasti në Bashkinë Korçë  
dhe në Bashkinë Berat*

Artur Hasanbelliu

---

Drejtore, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm  
Kontrolli i Lartë i Shtetit

**2017**

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), në kuadër të programit “Përdorimi efikas i hulumtimit dhe advokimit mundëson politika më të mira evropiane në nivel lokal në Shqipëri”, drejtuar pjesëmarrësve të Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike. Programi ka për qëllim të mbështesë aktivitetet kërkimore dhe advokuese të alumnëve të Shkollës (rreth 300 drejtues të rinj nga profile dhe eksperiencia të ndryshme profesionale) me synim përmirësimin e politikave në nivel vendor.

Punimet hulumtuese u fokusuan në këtë fushë për shkak të implikimeve të rëndësishme të reformës administrativo-territoriale në nivelin e demokracisë vendore si dhe zhvillimeve të vullshme në qeverisjen vendore, të cilat kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me shërbimet që afrohen dhe janë të prekshme nga çdo qytetar.

Alumnët e përfshirë në këtë program patën mundësi të ndiqnin në terren pranë njësive të reja vendore ecurinë dhe problematikën e hasur në zbatimin e reformës administrativo-territoriale. Duke përballur eksperiencën e tyre profesionale dhe vendosur atë në kontekstin e zhvillimeve të përditshme të njësive të reja vendore, punimet e alumnëve tentojnë që të evidentojnë shembujt pozitivë në njësi të caktuara me qëllim replikimin në njësi të tjera, si dhe të ofrojnë rekomandime konkrete për përmirësimin e praktikave aktuale.

Këto punime kërkimore synohet të prezantohen në aktivitete publike apo advokuese me pjesëmarrjen e vendimmarrësve dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm, të cilët vijnë nga rrjeti alumni i shkollës dhe jo vetëm. Ofrimi i ekspertizës profesionale të këtyre hulumtimeve ndaj politikëbërësve siguron gjithashtu një platformë diskutimesh për shkëmbimin e ndërsjelltë të ideve të reja. Nga njëra anë, alumnët pjesëmarrës të këtyre aktiviteteve kanë mundësinë të sjellin rekomandimet e tyre për hartuesit e politikave të rëndësishme, por njëkohësisht, edhe vetë ata bëhen më aktivë dhe shërbejnë si përçues nga lart-poshtë të këtyre ideve tek shtresat e tjera të shoqërisë. Publikimi i mëtejshëm i hulumtimeve dhe ngjallja e interesit të publikut të gjerë do të ndihmojnë në krijimin e politikave dhe vendimmarrjen e orientuar nga konsultimi me publikun si dhe angazhimin e mëtejshëm të qytetarëve në këto procese politikëbërëse.

Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyron opinionin zyrtar të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe të Akademisë së Studimeve Politike. Përgjegjësia për informacionin dhe pikëpamjet e shprehura në publikim i përkasin tërësisht autorëve. Autorët falenderojnë mentoren znj. Gentiola Madhi për mbështetjen dhe sugjerimet e dhëna në hartimin e këtyre punimeve.

## PËRMBLEDHJE

Në Shqipëri dhuna në familje është një problem që ndikon negativisht tek gratë dhe fëmijët, si edhe tek familjet dhe bashkësitë. Megjithatë, shpesh priremi ta konsiderojnë dhunën në familje si një çështje private dhe si një pjesë normale të jetës bashkëshortore e familjare. Dhuna në familje u shfaq si problem shqetësues në Shqipëri në vitet '90, kur vendi po përjetonte ndryshime të mëdha politike dhe shoqërore. Ndonëse dhuna në familje kishte ekzistuar shumë kohë përpara kësaj periudhe tranzicioni, rastet e dhunës në familje pësuan rritje të ndjeshme në vitet '90, ndërkohë që familjet po përjetonin shumë stresa dhe trysni si pasojë e tranzicionit. Nisur nga niveli, shpeshësia si dhe kosto sociale, dhuna me bazë gjinore mbetet një shqetësim i madh në Shqipëri, si një nga dhunimet më serioze dhe të vazhdueshme të të drejtave të njeriut në vend.

Qeveria shqiptare ka hartuar Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje, si dhe një sërë ligjesh dhe vendimesh kanë krijuar kushtet që personat që vuajnë pasojat e këtij fenomeni të merren nën mbrojtjen e strukturave të specializuara të shtetit. Gjithashtu është krijuar Mekanizmi Kombëtar i Referimit të Dhunës në Familje (MKR), situatën e veprimit të së cilit synon ta paraqesë ky punim. MKR-ja dhe strukturat e saj fillojnë të veprojnë menjëherë sapo një rast i dhunës në familje bëhet prezent apo denoncohet. Pra, funksionimi i këtij mekanizmi është jetik për viktimat e fenomenit të dhunës në familje.

Bazuar në të dhënat dhe materiale e marra nga institucionet shqiptare, media e shkruar, vizive dhe elektronike, si dhe raportet e ndryshme mbi barazinë gjinore dhe dhunën në familje, u përzgjedh Bashkia e Korçës dhe Bashkia e Beratit si raste studimore të veprimit të MKR-së.

Në përfundim të këtij punimi do të mundësohen rekomandime konkrete për përmirësimin e veprimit të Mekanizmit Kombëtar të Referimit në këto dy bashki, me synim që këto rekomandime të mund të vlejnjë edhe për njësitë e tjera të qeverisjes vendore.

## FENOMENI I DHUNËS NË FAMILJE

Familja është grup individësh i lidhur nga gjaku ose nëpërmjet martesës, që jetojnë bashkë, bashkëpunojnë ekonomikisht dhe ndajnë përgjegjësitë për të rritur fëmijët. Familja është gjithashtu një grupim privat individësh, marrëdhëniet dhe sjelljet e të cilëve janë të padukshme për të tjerët; një organizim social kompleks që konsiston në shumëllojshmëri rolesh dhe statusesh; dhe së fundmi, marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të një familje janë më intime, më emocionale dhe më të ndjeshme.<sup>1</sup>

Duke u bazuar në vlerat universale të familjes, [Organizata e Kombeve të Bashkuara e përkufizon dhunën në familje](#) si një akt që rezulton, ose ka shumë mundësi të rezultojë në dëmtim fizik, seksual ose mendor duke përfshirë kërcënime ose akte të ngjashme, shtrëngimet ose heqjen arbitrare të lirisë.

Dhuna në familje është fenomen i përhapur në shoqërinë tonë, i cili ndodh mes partnerëve të ngushtë në familje, si dhe ndodh në të gjitha klasat shoqërore, pavarësisht moshës, arsimit, fesë, gjendjes ekonomike, etnisë ose identitetit kulturor. [Të dhënat zyrtare sipas anketimit të fundit për dhunën në familje në Shqipëri](#) tregojnë se të paktën 59.4% e grave kanë përjetuar një nga format e dhunës në familje. Dhuna në familje është një sjellje e udhëhequr nga nevoja për të pasur kontroll. Mund të nisë nga kërcënimet, telefonatat bezdisëse dhe ndjekjet e deri tek marrëdhëniet seksuale të padëshiruara, goditjet, dhe në rastin më të keq deri në vdekje. Dhuna në familje zakonisht nuk është një rast i veçantë dhe shpesh bëhet më e ashpër dhe më e shpeshtë me kalimin e kohës. Në mënyrë të përsëritur dhunuesit e mohojnë dhunën në familje dhe ashpërsinë e kësaj dhune. Kur ballafaqohen me sjelljen e tyre abuzive, ata kanë tendencën të fajësojnë partneren e tyre se i ka provokuar, ose refuzojnë të pranojnë përgjegjësinë. Shpesh abuzuesi shpreh keqardhje dhe viktimat dëshiron të besojë që abuzimi nuk do të ndodhë më. Megjithatë ka një sërë faktorësh që çojnë në dhunë në familje, kjo gjithmonë është e lid-

1 Ohlin, L. dhe Tonry M. ed. "Family Violence", Crime and Review, The University of Chicago Press, Cikago dhe Londër, Vol. 11, f. 124-129.

hur me pabarazitë dhe çekuilibrin e pushtetit në marrëdhënie. Por më pas, ndodh përsëri e përsëri. Dhuna përshkallëzohet nëse nuk ndërmerren masa për të ndryshuar situatën. Dhuna në familje është problem kompleks që përfshin më shumë se sa një akt në vetvete në marrëdhëniet personale mes burrit dhe gruas. Është një problem social me përmasa të gjera që i ka rrënjët në qëndrimet historike ndaj gruas në nivel martesor. Socializimi i grave dhe burrave në shoqërinë tonë dhe caktimi i grave në role dhe pozita inferiore që i mbajnë gratë të varura ekonomikisht, i bëjnë ato me të ekspozuara ndaj dhunës së burrave. Ky viktimizim i grave nga bashkëshortët e tyre përforcohet nga gjendja ekonomike, mentaliteti dhe tradita, si dhe ndërjegjësimi jo i mjaftueshëm i njerëzve mbi dhunën në familje. Ndërsa dhuna ndaj gruas po bëhet gjithmonë dhe më tepër problem shqetësues në shoqëri, pasi shumë burra ndihen të kërcënuar nga koncepti i lirisë së grave.

Dhuna në familje u shfaq si problem shqetësues në Shqipëri në vitet '90, kur vendi po përjetonte ndryshime të mëdha politike dhe shoqërore, por dhuna në familje ndaj grave nuk është dukuri e re në Shqipëri; ajo i ka rrënjët thellë në traditat dhe zakonet patriarkale që prej kohësh i kanë dhënë formë shoqërisë shqiptare. Studimi i dhunës në familje **vështirësohet po të kemi parasysh edhe një numër tabush që nuk lejojnë depërtimin në thelbin e problemit. Kështu, në komunitete dhe mjedise të ndryshme sociale ndahen mendime se “dhuna prek vetëm një shtresë apo grupe të caktuara”, “dhuna është një problem i të varfërve”, “gratë e dhunuara kanë personalitete të caktuara që e nxisin ushtrimin e dhunës nga bashkëshorti”, “gratë e dhunuara qëndrojnë në marrëdhënie të dhunshme sepse ato e pranojnë dhunën”, “dhuna është rastësore dhe ndodh shumë rrallë”, etj.** Të gjitha këto etiketime çojnë në një theksim të stereotipit të shoqërisë patriarkale dhe bëjnë të mirëqenë konceptin se dhuna është një fenomen i cili vazhdon të pranohet.

Dhuna në familje **përbën abuzimin më të shpeshtë me të drejtat e njeriut, por njëkohësisht mbetet i izoluar në qarkun e mbyllur të familjes. Ky abuzim është edhe një problem shëndetësor i cili bëhet shkak për**

**plagë shpirtërore, fizike madje dhe vdekje. Ai cenon mirëqenien e grave dhe gërryen dinjitetin dhe vetëvlerësimin e tyre. Është fakt i mirënjohur që dhuna në familje është një fenomen, i cili i kapërcen të gjithë kufijtë dhe gjendet në të gjitha kulturat apo shtresat e shoqërisë. Rastet më të shpeshta të dhunës në familje kanë për viktima femrat që kryesisht janë nëna me fëmijë të mitur (gjithashtu viktima të dhunës në familje). Dhuna në familje dhe abuzimi ndaj grave është një problem kompleks dhe shumëdimensional. Kjo sepse përfshihen faktorë familjarë, individualë, shoqërorë dhe kulturorë. Këta faktorë ndikojnë në probabilitetin që gratë mund të bëhen viktima të dhunës.**

*Qëllimi i këtij punimi është paraqitja e situatës së veprimit të Mekanizmit Kombëtar të Referimit të dhunës në familje. Ky mekanizëm është themeli i ofrimit të ndihmës së parë për viktimat e dhunës në familje. Për realizimin e këtij punimi janë përdorur materiale, të cilat janë siguruar në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në të cilën ka një sektor të veçantë i cili merret me problematikat e barazisë gjinore. Gjithashtu janë shfrytëzuar materiale të marra nga media e shkruar dhe ajo vizive si dhe raporte të ndryshme mbi barazinë gjinore dhe dhunën në familje. Bazuar në këto materiale u përzgjedh Bashkia e Korçës dhe Bashkia e Beratit si raste studimore të veprimit të Mekanizmit Kombëtar të Referimit. Në këto dy bashki u kryen intervista dhe pyetësorë me punonjësit e bashkisë, të cilët ligji i ngarkon me përgjegjësi për zbatimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit, si dhe me punonjësit e policisë, të cilët në shumicën e rasteve janë të parët që përballen me këtë fenomen.*

## **ANALIZA E SITUATËS**

Nga të dhënat e marra nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë rezultojnë se gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2016 janë evidentuar dhe trajtuar 4,157 raste të dhunës në familje, ndërsa gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2015 janë evidentuar 3,866 raste të dhunës në familje. Duke krahasuar treguesit e periudhave të mësipërme, rezultojnë se *gjatë vitit 2016 janë evidentuar 297 raste të dhunës në familje me shumë, ose rreth 7.7% më shumë.*

**Tabela 1:** Rastet e evidentuara të dhunës në familje sipas qarqeve të vendit

	Totali	Drejtoritë e Policisë së Qarqeve											
		Tiranë	Durrës	Vlorë	Shkodër	Berat	Fier	Kukës	Dibër	Elbasan	Gjiro-kastër	Korçë	Lezhë
Evidentuar	4163	1594	626	255	166	249	276	48	66	252	80	312	239
Urdhër Mbrojtjeje	2207	711	469	163	73	146	104	20	20	131	56	181	133
Shkelje e Urdhrit të Mbrojtjes	119	50	16	3	4	12	7	0	2	7	1	9	8
Fillim Procedimi Penal	1956	883	157	92	93	103	172	23	46	121	24	131	106
Vepër Penale Neni 130/a	1488	658	97	73	66	82	149	25	37	101	19	105	76
Arrestuar total/ Vepër Penale neni 130/a	944/742	415	65	44	39	526	86	15	31	52	13	76	56
Ndaluar total/ Vepër Penale neni 130/a	173/111	82	17	4	7	5	29	2	1	5	4	14	3
Rastet e vrasjeve/viktima	16/17	6	1	1	2	1	2	0	0	1	0	2	0
Tentativë vrasje/ viktima	7/10	1	1	1	1	0	0	0	1	0	0	1	1

Burimi: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, 2017.

Gjatë vitit 2015 janë plotësuar 2,148 kërkesë-padi “Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes/Urdhrit të Mbrojtjes”, ndërsa për vitin 2016 janë trajtuar me **kërkesë-padi 2,207 raste**. Gjatë vitit 2016 vërehet rritje e indikatorit kërkesë padi për Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtjeje/Urdhër Mbrojtjeje me 59 raste ose rreth 3% më shumë se sa në vitin 2015.

Gjatë vitit 2016 të dëmtuara nga dhuna në familje kanë qenë **3,062 gra/vajza** ose 78% të numrit total të viktimave të dhunës, ndërsa 1,095 ose 22% janë burra. Viktimat gra/vajza janë bashkëshorte, motra, kunata nëna, bija dhe numri i madh i tyre tregon qartë për ndikimin gjinor të dhunës. Ndërkohë vetëm **bashkëshorte të dëmtuara** nga dhuna janë 1,531 ose rreth 36.8 % të numrit total të viktimave të dhunës në familje, ose 50% e numrit total të grave/vajzave të dëmtuara nga dhuna në familje. Sa i përket **të miturve nën 18 vjeç**, të dëmtuar nga dhuna dhe krime të tjera të ndodhura në familje, janë **186 raste**.

Për vitin 2016 vihet gjithashtu re se në 119

raste janë shkelur Urdhrat e Menjëhershëm të Mbrojtjes//Urdhrat e Mbrojtjes të dhëna nga Gjykatat e Shkallës së Parë, ndërsa gjatë vitit 2015 janë evidentuar/trajtuar 112 raste të shkeljes së Urdhrave të Mbrojtjes.

Gjatë vitit 2016 janë referuar materialet në prokurori, në bazë të nenit 130/a të Kodit Penal<sup>2</sup> për 1,488 raste, kundrejt 1,299 rasteve

2 Neni 130/a i Kodit Penal: Dhuna në familje: Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet. Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet. Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me au-



**Tabela 2:** Krahasimi i situatës për vitet 2015-2016

Viti	Totali i rasteve të evidentuara në polici	UMM/UM	Shkelje e UMM/UM	Referuar në Prokurori		Vrasje	Viktima
				Arrestuar	Ndaluar		
2015	3866	2148	112	1299		18	20
				588	101		
2016	4163	2207	119	1488		16	17
				742	111		

Burimi: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, 2017.

të referuar në 2015. Nga krahasimi i treguesve rezulton se, gjatë vitit 2016 janë referuar në prokurori 189 raste, ose 14.5% me shumë vepra penale, si dhe janë arrestuar 154 autorë më shumë. Rritja e numrit të arrestimeve është një masë parandaluese ndaj dhunës dhe krimit në familje.

Gjatë vitit 2016 kanë ndodhur 16 vrasje në familje (përkatesisht sipas nenit 79/c të Kodit Penal)<sup>3</sup>, me 17 viktima. Gjatë vitit 2015 u evidentuan 18 vrasje me 20 viktima. Nga krahasimi i numrit të vrasjeve, gjatë vitit 2016 u evidentua një vrasje më pak se në vitin 2015, si dhe 3 viktima më pak.

Në tabelën 2 paraqitet situata krahasuese për vitet 2015-2016 lëshimit të Urdhrave të Mbrojtjes, Urdhrave të Menjëhershëm të Mbrojtjes, rasteve të arrestuar dhe atyre të ndaluar.

Gjatë vitit 2015, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer Auditimin e Performancës me temë “Efektiviteti i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje 2011-2015”. Mesazhi i këtij auditimi ishte: “Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduk-

timin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje rezulton të jetë pjesërisht efektive. Ekziston kuadri ligjor për mbrojtjen e viktimave të DHF por është i pa plotë dhe ka nevojë për përmirësim. Nuk funksionon mekanizmi i cili duhet të ofronte mbrojtjen administrative. Anëtarët e MKR, policia, prokuroria duhet të marrin përsipër përgjegjësitë që u ngarkon ligji. Burimet financiare dhe ato njerëzore janë të pa mjaftueshme. Niveli profesional i personave që ofrojnë shërbimet është në përputhje me pozicionet përkatëse por mungojnë trajnimet specifike profesionale dhe teknike të stafit sipas nevojave. Strukturat përgjegjëse kanë miratuar standardet e shërbimeve bazuar tek ato ndërkombëtare por implementimi i tyre në terren lë për të dëshiruar. Ekzistojnë mundësitë që shërbimet sociale për këtë grup shoqëror vulnerabil të ofrohen nga operatorët privatë të licencuar në këtë fushë dhe ku fitues përzgjidhet ofruesi i cilësisë më të lartë të shërbimit dhe jo çmimit më të ulët të tij”. Në përfundim të auditimit Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Vendimin nr. 185, datë 31.12.2015 ka miratuar Raportin përfundimtar të Auditimit dhe ka dërguar rekomandimet përkatëse në MMSR si dhe për njësitë vendore të marra nën auditim.

## MEKANIZMI KOMBËTAR I REFERIMIT

[Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunën në Familje 2016-2020](#) është dokumenti themelor i shtetit shqiptar për të përmbushur angazhimet e rëndësishme ligjore, kombëtare dhe ndërkombëtare në parandalimin dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Ky dokument synon mbështetjen me shërbime ligjore, psiko-sociale, riintegrimin në shoqëri dhe

torin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet. Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet.

- 3 Neni 79/c i Kodit Penal: Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare: Vrasja me dashje e personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

ndihmë ekonomike për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Në zbatim nenit 8/8 të [Ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006](#), “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, është miratuar [VKM-ja nr.334 datë 17.02.2011](#), “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”. Bazuar në këtë VKM, ngrihet dhe funksionon Mekanizmi Kombëtar i Referimit, i cili përcakton në mënyrë të qartë institucionet e përfshira si dhe rrugën që duhet ndjekur për trajtimin e një rasti të dhunës në familje. MKR në nivel vendor përbëhet nga Komiteti Drejtues, Ekipi Teknik Ndërdisciplinor dhe Koordinatori Vendor.

1. *Komiteti Drejtues* drejtohet nga kryetari i njësisë vendore dhe ka në përbërje përfaqësues të strukturës së policisë, gjykatës së rrethit gjyqësor, prokurorisë së rrethit, drejtorisë arsimore, drejtorisë së shëndetit publik, strukturës për shërbimet sociale pranë njësisë vendore, zyrës së përmbarrimit, përfaqësues i prefekturës, përfaqësues i zyrës përkatëse të punësimit, drejtues të organizatave jofitimprurëse që në merren me çështje të dhunës në familje, drejtues të qendrave/strehëzave të ngritura për viktimat e dhunës, përfaqësues të institucioneve fetare, që mund të ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe drejtuesi i Dhomës së Avokatisë së Rrethit.

Komiteti Drejtues raporton në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë çdo tre muaj të dhënat dhe problematikën e dhunës në familje. Ky komitet miraton në parim marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shtetërore për realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të ligjit, gjithashtu organizon trajnime të përbashkëta ndërdisciplinore të personelit në varësi të tyre, të cilët merren me çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe siguron njohjen e qytetarëve me funksionet e Komitetit Drejtues dhe strukturave të tjera teknike të rritit si dhe mënyrat e kontaktimit të tyre.

2. *Ekipit Teknik Ndërdisciplinor* ngrihet me vendim të Komitetit Drejtues dhe ka në përbërje përfaqësues teknik të institucioneve të

përfaqësuar në këtë komitet, përfaqësues të njësisë për mbrojtjen e fëmijëve dhe nëpunës vendorë të barazisë gjinore, pranë asaj njësie të qeverisjes vendore, si dhe nga profesionistë të lirë (avokatë, psikologë etj.). Ky ekip ka këto detyra:

- ndjekjen e rastit dhe plotësimin e nevojave të viktimave, duke siguruar edhe lidhjen e tyre me shërbimet e përshatshme;
- koordinimin dhe mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve;
- menaxhimin e rasteve;
- përcjelljen e të dhënave për rastet konkrete të drejtuesit të ekipit teknik ndërdisciplinor;
- monitorimin dhe raportimin në komitetin drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave.

3. *Kordinatori Vendor* për referimin e rasteve të dhunës në familje, caktohet pranë çdo bashkie dhe është përfaqësuesi i zyrës së shërbimeve sociale pranë asaj njësie të qeverisjes vendore. Ai/ajo drejton punën e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor; bën ndërmjetësimin pranë OJF dhe strukturave të tjera shtetërore që ofrojnë shërbimet, policisë, gjykatave; bën asistimin e viktimave për ndjekjen e procedurave për marrjen e Urdhrit të Mbrojtjes dhe Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes; mbikëqyr mirëmbajtjen dhe përditësimin e dosjeve të referuara; organizon dhe monitoron takimet për menaxhimin e rasteve; mban lidhje me strukturën përgjegjëse në ministrinë përkatëse nëpërmjet koordinimit të organizimit të trajnimeve që ndërmerr kjo strukturë për ekipin teknik ndërdisciplinor dhe personelin tjetër që punon me komunitetin; mban e një data baze për rastet e referuara, harton raporte tre mujore të cilat paraqiten në Komitetin Drejtues, etj.

## RASTI BASHKISË SË KORÇËS

Në Bashkinë e Korçës marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve që më pas kanë përbërë edhe Komitetin Drejtues është nënshkruar në 19.05.2010. Mbledhja e radhës së Komitetit Drejtues u realizua në 7.12.2016, gjatë së cilës u rinëshkrua “Marrëveshja e Bashkëpunimit” pasi kanë ndryshuar rrethanat si më poshtë:

- Së pari, janë shtuar shërbimet e Zyrës Kundër Dhunës në Familje;
- Së dyti, me ndryshimet e reja administrativo-territoriale u përfshinë shtatë njësitë e reja administrative në marrëveshje dhe do të ndryshojnë emërtimet;
- Së treti, Fondacioni Kenedi është zëvendësuar me Fondacionin “Kisha e Jezu Krishtit për Ballkanin” dhe do të administrojë strehëzën për rastet emergjente të dhunës në familje;

Ekipi Teknik Ndërdisciplinor gjatë vitit 2016 ka realizuar **4 mbledhje të zakonshme**, (përkatesisht në datat 04/02/2016; 20/04/2016; 21/09/2016; 21/11/2016), ku kanë marrë pjesë shumica e anëtarëve të saj, por jo të gjithë. Vihet re që duhet një përpjekje e herë pas herëshme që secili nga institucionet ta marrë seriozisht detyrimin që i buron nga ligji, përfshi e marrjen pjesë në mbledhjet periodike.

Koordinatori Vendor në Bashkinë e Korçës është në pozicionin e Specialistit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Barazinë Gjinore, në Drejtorinë e Kujdesit Social. Specialistja e ushtronte këtë detyrë që prej hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 334/2011, kohë që përkon edhe me krijimin e pozicionit të punës.

Koordinatori Vendor ka arsimin përkatës, sipas specifikimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit të Bashkisë së Korçës si dhe ka marrë pjesë në trajnime për problematikën e dhunës në familje të organizuara nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe partnerë të tjerë aktivë në mbrojtjen e të drejtave të personave që vuajnë dhunën në familje.

Nga sa më sipër vërehet se aktorët që kanë për

detyrë zbatimin e MKR-së ushtrojnë detyrën e tyre konform kuadrit ligjor dhe për rrjedhojë trajtimi i rasteve të paraqitura bëhet sipas legjislacionit dhe në kohën e duhur, duke bërë të mundur ofrimin e ndihmës dhe parandaluar në këtë mënyrë agravimin e situatës për personat viktimë të dhunës në familje.

## RASTI BASHKISË SË BERATIT

Në Bashkinë e Beratit edhe pse kanë kaluar mbi 6 vjet, nga hyrja në fuqi e VKM nr. 334/2011, **Komiteti Drejtues nuk është krijuar ende**. Ka patur një tentativë nga ana e Kryetarit të Bashkisë, i cili ka kërkuar nga institucionet e tjera të dërgojnë përfaqësuesit e tyre në Komitetin Drejtues si dhe të përgatisin marrëveshjen e bashkëpunimit të anëtarëve të Mekanizmit Kombëtar të Referimit por marrëveshja nuk është nënshkruar, pra Komiteti Drejtues nuk është mbledhur asnjëherë. Duke bërë të pamundur ngritjen zyrtarisht të Ekipit Teknik Ndërdisciplinor.

Situata e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor paraqitet e paqartë. Edhe pse Komiteti Drejtues nuk e ka ngritur zyrtarisht Ekipin Teknik Ndërdisciplinor, ai mbledhet me iniciativën e specialistes përgjegjëse në strukturën e Bashkisë së Beratit për Dhunën në Familje e cila sipas ligjit është Koordinatorja Vendor. Në këtë **situatë konfuze**, ajo përpiqet të kryejë detyrat me të cilat është ngarkuar. Nuk është realizuar asnjë mbledhje e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor për vitin 2016.

Koordinatori Vendor në Bashkinë e Beratit është në nivelin e Specialistit të Nivelit të Lartë për Shërbimet Sociale, Barazinë Gjinore, Dhunën në Familje, Marrëdhëniet me OJF-të dhe Rininë në Drejtorinë e Shërbimit Social dhe Rinisë.

Bashkëpunimi ndërmjet Koordinatorit Vendor dhe specialistes së zyrës për të miturit dhe dhunën në familje në Drejtorinë e Policisë Berat nuk realizohet; por rastet trajtohen vetëm nga ana e strukturave të Policisë Shtetit dhe jo në përputhje me VKM-së nr. 334/2011.



## KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Bazuar në analizën e të dhënave të vëna në dispozicion nga ana e Sektorit të Barazisë Gjinore në Drejtorinë e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, intervistave të kryera me personat të cilët kanë përgjegjësi për zbatimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit në Njësitë Vendore të Korçës e Beratit, si dhe analizës së raportimeve të botuara në median e shkruar për situatën e fenomenit të dhunës në familje, dalim në konkluzionin se:

- **Fenomeni i Dhunës në Familje ka pësuar rritje në vitin 2016** krahasuar me një vit më parë. Kësaj rritjeje institucionet përgjegjëse për zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi duhet ti përgjigjen me intensifikim e bashkëpunimit ndërmjet tyre.
- **Në Bashkinë e Korçës** rezulton se Koordinatori Vendor është në nivelin e specialistit të Mbrojtjes nga Dhuna në Familje dhe Barazisë Gjinore dhe bashkëpunimi ndërmjet tij dhe institucioneve të ngarkuara për zbatimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit është i mirë. **Trajtimi i rasteve të paraqitura bëhet konform legjislacionit dhe në kohën e duhur**, duke bërë të mundur ofrimin e ndihmës dhe parandaluar në këtë mënyrë agravimin e situatës për personat viktime të dhunës në familje.
- **Në Bashkinë e Beratit situata është e paqartë.** Nuk është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse, e cila automatikisht do të krijonte edhe Komitetin Drejtues i cili më pas duhet të krijonte Ekipin Teknik Ndërdisciplinor me të cilin Koordinatori Vendor, nëpunës i bashkisë do të duhet të trajtonte rastet e dhunës në familje. Personi i ngarkuar me ligj si Koordinator Vendor është specialist për Shërbimet Sociale, Barazinë Gjinore, Dhunën në Familje, Marrëdhëniet me OJF-të dhe Rininë, nga vetë emërtimi që ka ky punonjës kuptohet se mundësia për tu marrë me problematikën e dhunës

në familje është shumë e vogël. Praktikisht rastet e dhunës në këtë bashki trajtohen përgjithësisht nga ana strukturës së Policisë së Shtetit dhe në pak raste nga ana e Koordinatorit Vendor.

Për të adresuar nevojat e sipërpërmendura rekomandohet sa më poshtë për institucionet qendrore dhe vendore, të cilat kanë për detyrë trajtimin e fenomenit të dhunës në familje.

### **Për Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:**

- Me anë të mekanizmave ligjorë **të ushtrijë presion** mbi Njësinë e Qeverisjes Vendore, përkatësisht mbi Bashkinë e Beratit, si dhe institucionet e tjera anëtare të Komitetit Drejtues që të nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit të anëtarëve të Mekanizmit Kombëtar të Referimit.
- **Për Bashkinë e Beratit:** Mungesa e marrëveshjes së bashkëpunimit e për pasojë mos krijimi i Komitetit Drejtues në këtë bashki ka bërë që Mekanizmi Kombëtar i Referimit të mos ekzistojë. Për pasojë rastet e dhunës në familje nuk janë trajtuar në përputhje me Ligjin nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, si dhe VKM-në nr. 334 datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”. **Kryetari i Bashkisë së Beratit duhet të marrë masa të menjëhershme për thirrjen e Komitetit Drejtues, nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe ngritjen e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor.**
- Personi i ngarkuar me ligj si Koordinator Vendor për dhunën në familje në Bashkinë e Beratit është në nivelin e Specialistit për Shërbimet Sociale, Barazinë Gjinore, Dhunën në Familje, Marrëdhëniet me OJF-të dhe Rininë.

*Kryetari i Bashkisë së Beratit duhet të ndërmarrë hapat e duhur për të bërë ndryshime në organikën e Drejtorisë së Shërbimit Social dhe Rinisë, duke ndarë nga funksionet e tjera specialistin e ngarkuar si Koordinator Vendor për dhunën në familje.*

## **BURIME:**

1. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe Dhunën në Familje (CETS Nr. 210), Stamboll, 11.05.2011;
2. Ligji Nr. 23/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
3. Ligji Nr. 9669, dt. 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”;
4. Raportet e monitorimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunën në Familje 2011-2015;
5. VKM, nr. 334, dt. 17.02.2011, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”;
6. VKM Nr. 122, datë 2.2.2009 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore”;
7. Urdhër Nr. 230 datë 2.12.2013 të Kryeministrit “Për ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore”;
8. Vendimi Nr. 185 datë 31.12.2015, i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për evadimin e materialeve të auditimit të performancës “Efektiviteti i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje 2011-2015”.